



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit
Mbledhja nr. 05

Prishtinë, më 19.1.2015, në orën 19:45

Ndërtesa e Kuvendit, salla N 303

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Në mbledhje morën pjesë: Selville Halimi, Danush Ademi, Agim Aliu, Nezir Çoçaj, Agim Ademaj dhe Doruntinë Maloku.

Munguan: Albulena Haxhiu, Melihate Tërmkolli, Armend Zemaj, Milena Miliqeviq dhe Jakup Krasniqi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Lejla Selimi, OSBE.

Nga Stafi i Komisionit: Visar Krasniqi dhe Hana Bajraktari.

Mbledhjen e kryesoi, Selville Halimi, nënkryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre;
3. Të ndryshme .

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryesuesja konstatoi se rendi ditës miratohet pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre;

Kryesuesja tha se thirrja e mbledhjes është bërë pasi që Kuvendi ka bërë shmangie të rregullores dhe e ka miratuar në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/-035, për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre dhe ka ngarkuar Komisionet kryesore që ta shqyrtojnë sipas fushëveprimit të tyre. Ajo sqaroi se ka bërë përpjekje për të kontaktuar me kryetaren e Komisionit, mirëpo, ajo nuk është përgjigj, andaj sipas rregullores, në mungesë të kryetarit, mbledhjen e thërret nënkryetari.

Në vazhdim ajo para deputetëve lexoi dy amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional si:

Amendamenti 1, Neni 2, pas fjalës “Ligjit”, shtohet fjala “bazik”, kurse **Amendamenti 2** Neni 3, riformulohet si vijon: Neni 41, paragrafi 1, i Ligjit bazik, fshihet dhe riformulohet si në vijim:

1. Gjykata lëshon vendim për fillimin e procedurave të likuidimit në bazë të Ligjit të ndryshuar për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, pas kalimit të periudhës prej 18 (tetëmbëdhjetë) muajsh nga afati maksimal i lejuar me Nenin 22, të Ligjit bazik dhe me pajtim me Neni 2, të këtij Ligji dhe, në rast se edhe pas këtij afati:

Në fund, ajo kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë vërejtje në Projektligj dhe amendamentet e propozuara.

Meqë nuk kishe vërejtje, ajo hodhi në votim dhe me 6 vota “për”, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t’i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

3. Të ndryshme.

Në këtë pikë nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 20:00

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit

Nënkryetare e Komisionit
Selvije Halimi